



HASANI: TËRHEQJA E SHBA-së DO TA ZBEHË RËNDËSINË E MENDIMEVE TË KOMISIONIT TË VENECIAS NË BALLKAN

FAQE 4-5



Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, aktualisht profesor i të Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, thotë se tërheqja e Shteteve të Bashkuara nga Komisioni i Venecias, ku nuk ishte anëtar, por vetëm vëzhgues, do ta zbehë peshën dhe rëndësinë e mendimeve të këtij institucioni në Ballkanin Perëndimor. Sipas Hasanit, ndër ndikimet më të mëdha të pranisë së Uashingtonit në këtë institucion kishte të bënte me vendet e Ballkanit Perëndimor

**STABILIZOHET
SITUATA
E VËRSHIMEVE
NË KOSOVË**

F. 3



**BËHET APEL
PËR KUJDES
NË TRAFIK PAS
RESHJEVE TË BORËS
NË KOSOVË**

F. 7



OPINION

**KUR KALENDARI KRIJON
AVANTAZH POLITIK DHE KUR
OPOZITA SILLET ME INDOLENCË
DHE KEQLEXIM**

F. 6

Shkruan:
Ibrahim GASHI



AKTUALE



**SHBA-ja TËRHIQET NGA 66
ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE**

F. 2

**KURTI THYEN REKORD ME MBI 400
MIJË VOTA, LV-ja FITON MBI 51 %**

F. 5

EKONOMI



**PA KARTELË, ME EURO NË DORË: SI
E DËMTOJNË PAGESAT ME PARA TË
GATSHME BUXHETIN E KOSOVËS?**

F. 8

**95 % E EKONOMIVE FAMILJARE
JANË PRONARE TË SHTËPIVE OSE
BANESAVE ME AKT LIGJOR**

F. 8

SPORT

**FFK-ja NË BASHKËPUNIM ME UEFA-n
MBAJNË PUNËTORINË E PARË
MJEKËSORE NË NIVEL VENDI**

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja TËRHIQET NGA 66 ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE

WASHINGTON, 8 JANAR - Presidenti amerikan Donald Trump ka nënshkruar vendimin për tërheqjen e Shteteve të Bashkuara nga 66 organizata ndërkombëtare që administrata i konsideroi si “joefektive dhe të dëmshme”. Në mesin e tyre janë Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës, Mekanizmi Ndërkombëtar për Tribunale Penale (pasardhësi i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë), UN Women e Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC). Në këtë të fundit, Kosova bën pjesë, së bashku me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe kjo organizatë synon forcimin e bashkëpunimit politik, ekonomik dhe shoqëror në Ballkanin

Perëndimor dhe Evropën Juglindore dhe synon afrimin e rajonit me Bashkimin Evropian. Në Komisionin e Venecias - që është trup këshillues për çështje kushtetuese dhe jep rekomandime për parlamentet dhe qeveritë - ShBA-ja ishte vëzhguese e jo anëtare. Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, tha se këto organizata janë “antiamerikane ose të padobishme”. Po ashtu, ShBA-ja është tërhequr nga disa organizata të tjera të Kombeve të Bashkuara përfshirë nga Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Sociale, Qendra Botërore e Tregtisë, Komisioni i Ligjit Ndërkombëtar, Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për



Fëmijë në Konflikte të Armatosura, Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për Dhunën Seksuale në Konflikt, Fondi i OKB-së për Demokraci

dhe një sërë organizatash dhe traktatesh ndërkombëtare. “Nuk do të vazhdojmë të shpenzojmë burime, kapital diplomatik dhe peshën legjitimues të pjesëmarrjes sonë në

institucione që janë të parëndësishme për interesat tona ose bien ndesh me to. Ne e refuzojmë inercinë dhe ideologjinë në favor të maturisë dhe qëllimit. Ne kërkojmë bashkëpunim aty ku ai u shërben njerëzve tanë dhe do të qëndrojmë të palëkundur aty ku nuk ndodh”, u tha në njoftimin e Shtëpisë së Bardhë. Sekretari Rubio shtoi se me këtë tërheqje po materializohet premtimi kyç i presidentit Trump se do të “ndalojë subvencionimin e burokratëve globalistë që veprojnë kundër interesave tona. Administrata Trump do ta vendosë gjithmonë Amerikën dhe amerikanët në radhë të parë”. ShBA-ja tha se po vazhdon rishikimi i organizatave të tjera ndërkombëtare.

VUÇIQI I AKUZON KOSOVËN, SHQIPËRINË DHE KROACINË PËR ALEANCË USHTARAKE “SULMUESE”

BEOGRAD, 8 JANAR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, pretendon se Tirana, Prishtina dhe Zagrebi kanë themeluar “aleancë ushtarake, sulmuese”. “Kjo është një aleancë sulmuese. Ka njerëz që ëndërrojnë se kur ka konflikt midis pjesëve të Perëndimit dhe Rusisë, kjo është një mundësi për ish-aleatët rusë, si ne, që të shkatërrohen



plotësisht”, tha Vuçiq për TV Informer. Lideri serb i ka akuzuar

vazhdimisht Kroacinë, Shqipërinë dhe Kosovën për themelimin e një aleance ushtarake kundër Serbisë dhe popullit serb në muajt e fundit. Ministrat e Mbrojtjes të Kroacisë, Shqipërisë dhe Kosovës nënshkruan një deklaratë për forcimin e bashkëpunimit në mbrojtje në mars të vitit 2025.

Qeveria kroate i tha më parë Radios Evropa e Lirë se Deklarata nuk synon të krijojë ndonjë aleancë ushtarake, dhe as nuk nevojitet një aleancë e tillë përkrah NATO-s. Duke iu përgjigjur akuzave të mëparshme të Vuçiqit, ministri i Brendshëm kroat, Davor Bozhinović, bëri thirrje për paqe dhe bashkëpunim në rajon.

“Kroacia është anëtare e Bashkimit Evropian dhe çdo gjë që bën në marrëdhëniet ndërkombëtare bëhet në mënyrë transparente”, tha Bozhinović më 6 janar. Kroacia dhe Shqipëria janë anëtare të NATO-s, ndërsa Kosova, pavarësinë e së cilës Serbia nuk e njeh, nuk është anëtare e aleancës.

SHBA NUK JEP AFATE: NAFTËN E VENEZUELËS DO TA SHESIM NE PËR NJË PERIUDHË TË PACAKTUAR

WASHINGTON, 8 JANAR - Shtëpia e Bardhë pohoi se ka në plan t'i kontrollojë shitjet e naftës së Venezuelës “për një kohë të pacaktuar”, teksa administrata Trump harton plane për kompanitë amerikane të naftës që të kthehen në vend. Më herët, Donald Trumpi deklaroi për të parën herë hapur se qeveria e përkohshme e Venezuelës do t'i “kthente” ShBA-së midis 30 dhe 50 milionë fuçi naftë “me cilësi të lartë”.

Nafta me vlerë mbi 2 miliardë dollarë do të merret nga magazinimi me anije dhe do të sillet direkt në portet e shkarkimit të ShBA-së, shkroi ai në “Truth Social”, ku shtoi se nafta do të shitet me çmimin e saj të tregut dhe paratë e gjeneruara nga shitjet do të kontrollohen nga ai vetë, në të mirë të popullit venezueljan dhe atij amerikan. Sekretari i Energjisë, Chris Wright, të cilit i është kërkuar ta

zbatojë planin, më vonë tha pas kësaj se: “Ne duhet të kemi atë levë dhe atë kontroll të këtyre shitjeve të naftës për të nxitur ndryshimet që thjesht duhet të ndodhin në Venezuelë”. Trumpi ka sugjeruar që kompanitë amerikane të naftës ta fillojnë punën në këtë vend brenda 18 muajsh dhe e ka kërcënuar regjimin e përkohshëm të Venezuelës me më shumë ndërhyrje ushtarake nëse nuk bashkëpunon. Shtëpia



e Bardhë konfirmoi se presidenti do të takohet të premten me drejtuesit e kompanive amerikane të naftës për të diskutuar mundësitë për investime në Venezuelë.

Aktualisht ekziston vetëm një kompani shumëkombëshe amerikane e naftës në Venezuelë - Chevron. Dy të tjera, Exxon Mobil dhe ConocoPhillips, u larguan pasi paraardhësi i Maduros, Hugo Chavez, shtetëzoi industrinë e naftës, duke i bërë ato të panevojshme. Venezuela ka rezervat më të mëdha të naftës së rëndë në botë, duke u renditur përpara vendeve si Arabia Saudite, përpara vendeve si Kanadaja dhe Rusia.

Kaos trafiku, dimri mbërthen Evropën

AMSTERDAM, 8 JANAR - Dimri ka mbërthyer rajone të tëra të Evropës, duke shkaktuar një kaos të vërtetë të lëvizjes. Reshjet e dëborës dhe ngricat po mendojnë kontinentin e vjetër. Problemet vazhdojnë në aeroportin e Amsterdemit Schiphol në Holandë, ku brenda dy ditësh janë anuluar mbi 700

fluturime. Më shumë se 1 000 pasagjerëve u është dashur ta kalojnë natën në aeroport duke fjetur në dyshekë palosës, sikurse njofton aeroporti në faqen e vet të internetit. Autoritetet atje parashikojnë, që moti dimëror me erëra të forta do të vazhdojë. Edhe qarkullimi i trenave në Holandë ka pasur pengesa dhe

anulime duke u paralizuar pjesërisht prej reshjeve të borës. Edhe në Francë moti ka shkaktuar probleme në qarkullim. Rrallëherë më parë ka qëndruar kaq gjatë shtresa e borës në Paris. Në kryeqytetin francez, shërbimi urban i autobusëve u ndërpre, në qarkullimin e tramvajeve, metrosë dhe trenave rajonalë ka

pasur pezullime e në aeroporte, po ashtu, u reduktuan fluturimet. Gjermania përgatitet dhe ajo për mot të trazuar: Pas reshjeve të ditëve të fundit pritet një valë më intensive bore deri të premten. Më pas vala e presionit të ulët do të lëvizë drejt Evropës Qendrore duke sjellë borë dhe akull, njofton shërbimi



sinoptik gjerman. Meteorologët insistojnë se sidomos të premten do të ketë ulje të temperaturave, shoqëruar me reshje bore, pasojë e një vale të re stuhish.

STABILIZOHET SITUATA E VËRSHIMEVE NË KOSOVË

Shirat e rrëmbyeshëm gjatë ditëve të fundit nxitën vërshime në pjesë të mëdha të Kosovës të cilat shkaktuan dëme materiale dhe detyruan autoritetet ta shtyjnë për disa ditë rifillimin e mësimit pas pushimit dimëror. Reshjet e mëdha shkaktuan dëme në prona dhe infrastrukturë, evakuime si dhe bllokim rrugësh. Por, fatmirësisht, në këto vërshime nuk ka pasur viktima apo të lënduar

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 8 janar - Sipas të dhënave të pranuar nga Qendrat Operative Emergjente 112 dhe njësive operative në terren, të enjten se situata e vërshimeve në Kosovë ka shënuar përmirësim të dukshëm pas ndërprerjes së reshjeve të shiut dhe fillimit të reshjeve të borës. Niveli i ujit në lumenjtë kryesorë ka filluar të bie dhe nuk paraqitet rrezik i menjëhershëm për vërshime të reja.

Gjendja sipas rajoneve: Prishtinë dhe rrethinë: Vërshime të lokalizuara në nënkalime dhe bllokime të disa rrugëve dytësore; situata mbetet e menaxhueshme. Prizren: Gjatë natës janë raportuar shumë pak intervenime, kryesisht të natyrës teknike. Mitrovicë: Situatë kryesisht e qetë; në Mitrovicën e Jugut janë evakuuar disa familje përkohësisht si masë sigurie. Pejë: Dy intervenime të raportuara në Istog, përfshirë evakuimin e një familjeje; në komunat e tjera gjendja stabile. Gjakovë dhe Gjiilan: Situatë e qetë dhe nën kontroll; rënie e nivelit të ujit në lumenj.

Njësit Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në gjithë vendin janë të mobilizuar për ndihmë

qytetarëve pa dallim.

Sistemi i Komunikimit Emergjent 112 me Qendrën Operative të Agjencisë është në monitorim dhe koordinim të vazhdueshëm të situatës 24/7. “Reshjet e borës dhe ngricat kanë shkaktuar vështirësi në qarkullim rrugor në disa zona. Disa rrugë mbeten të bllokuara për shkak të shembjeve të dheut. Apelojmë te qytetarët për kujdes të shtuar në situatë. Agjencia e Menaxhimit Emergjent përveç reagimit me forca operative në mbarë vendin, ka mbështetur KEK-un dhe KOSTT-in me pompa thithëse me kapacitet të lartë për largimin e ujit nga objektet e prekura, të cilat janë ende në funksion sipas nevojës. Institucionet përgjegjëse janë në gatishmëri të plotë për reagim dhe koordinim, ndërsa situata vazhdon të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme 24/7 nga sistemi i komunikimit emergjent 112”, ka njoftuar Qendrat Operative Emergjente.

Fushë-Kosova, Malisheva, Rahoveci, Klina, Mitrovica, Vushtrria, Skenderaj dhe Gjakova janë komunat më të prekura nga vërshimet, sipas Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

Përveç dëmeve në prona, në këto pjesë të vendit pati edhe evakuime të banorëve nga shtëpitë e tyre.



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, falënderoi institucionet për reagimin ndaj vërshimeve për mbrojtjen e “jetës dhe pronës”. “Situata kërkon kujdes maksimal. U bëj thirrje qytetarëve të tregojnë vigjencë dhe të respektojnë me përpikëri udhëzimet e institucioneve kompetente. Bashkëpunimi i ngushtë dhe reagimi profesional mbeten vendimtare për përballimin me sukses të kësaj situatë”, ka shkruar ajo në “Facebook”. Osmani tha se Forca e Sigurisë së Kosovës është në gatishmëri të ofrojë mbështetje nëse paraqitet nevoja. Përmbytjet në disa rrugë bënë që Kompania për Distributim e Energjisë Elektrike (KEDS) të ndërpresë rrymën në Drenas, Malishevë

dhe Rahovec të martën.

Në Drenas, KEDS tha se “uji ka depërtuar në nënstacion, duke paraqitur rrezik serioz për funksionimin e sigurt të rrjetit elektrik”.

Më vonë, autoritetet njoftuan se furnizimi me energji elektrike u rikthye pas krijimit të kushteve të sigurta për ndërhyrje të KEDS-it.

Në rrjete sociale, banorë, zyrtarë komunalë dhe media lokale të qyteteve të ndryshme kanë publikuar foto dhe video që tregojnë përmbytjet.

Si pasojë e vërshimeve, rifillimi i mësimit pas pushimit dimëror është shtyrë deri më 12 janar. “Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është në komunikim të vazhdueshëm me të gjitha Drejtoritë

Komunale të Arsimit dhe, bazuar në informacionet e pranuar nga terreni, është konstatuar se fillimi i procesit mësimor i paraparë për ditën e enjte është i pamundur”, ka njoftuar ministria në detyrë e Arsimit, Arbërie Nagavci

Ajo bëri me dije se orët e humbura të enjten dhe të premten do të zëvendësohen gjatë pjesës së dytë të vitit shkollor 2025/2026 për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Kosova është përballur me përmbytje vitet e fundit, të cilat kanë shkaktuar kryesisht dëme materiale. Vlerësohet se dëmtimi i shtretërve të lumenjve, si pasojë e nxjerrjeve të paligjshme të zhavorrit, kontribuon shumë në përmbytjen e zonave.

OSMANI SYNON MANDATIN E DYTË PRESIDENCIAL: KEMI ENDE SHUMË PUNË, RRUGA VAZHDON

PRISHTINË, 8 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka publikuar një video në rrjetet sociale në kuadër të promovimit për marrjen e mandatit të dytë në krye të shtetit, ku përmend ‘arritjet e pesë viteve të fundit’ në politikën e jashtme dhe ‘forcimin e pozitës ndërkombëtare’ të Kosovës.

“Kosova nuk ka qenë vetëm pjesëmarrëse, por partnere dhe aleate, shpesh edhe udhëheqëse në tryezat kur marrin formë ngjarjet e botës”, ka deklaruar Osmani.

Ajo ka veçuar “marrëdhëniet historike” me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, rolin e Kosovës në arkitekturën



euroatlantike të sigurisë, si dhe pranimin e katër njohjeve të reja - Kenia, Sudani, Siria dhe Bahamas - që sipas shefes së shtetit “forcojnë legjitimitetin ndërkombëtar të shtetit” dhe “fuqizojnë zërin e Kosovës” në skenën botërore.

Në përmbyllje ajo ka kërkuar mandatin e dytë për të vazhduar punën në “interes” të Kosovës: “Kemi ende shumë punë sepse kur një rrugë ndërtohet në interes shtetëror, dhe përkushtim të singertë, ajo nuk mund të ndalet në mes - ajo rrugë vazhdon”.

Mandati i Osmanit përfundon në mars të vitit 2026. Në dy raundet e para të votimit, kandidatit për

president i duhen dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, përkatësisht 80 nga 120. Në raundin e tretë mjafton shumica e thjeshtë prej 61 votash, por vetëm nën kushtin që në sallë janë të pranishëm të paktën 80 deputetë.

Ndryshe, në bazë të përbërjes aktuale të legjislaturës së dhjetë kosovare, zgjedhja e Osmanit për një mandat të dytë presidencial është ende e pasigurt. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka paralajmëruar se mosarritja e një marrëveshjeje për këtë çështje mund ta çojë vendin sërish drejt zgjedhjeve të parakohshme.



HASANI: TËRHEQJA E SHBA-së DO TA ZBEHË RËNDËSINË E MENDIMEVE TË KOMISIONIT TË VENECIAS NË BALLKAN

Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, aktualisht profesor i të Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, thotë se tërheqja e Shteteve të Bashkuara nga Komisioni i Venecias, ku nuk ishte anëtar, por vetëm vëzhgues, do ta zbehë peshën dhe rëndësinë e mendimeve të këtij institucioni në Ballkanin Perëndimor. Sipas Hasanit, ndër ndikimet më të mëdha të pranisë së Uashingtonit në këtë institucion kishte të bënte me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Prishtinë, 8 janar - Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, aktualisht profesor i të Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, thotë se tërheqja e Shteteve të Bashkuara nga Komisioni i Venecias, ku nuk ishte anëtar, por vetëm vëzhgues, do ta zbehë peshën dhe rëndësinë e mendimeve të këtij institucioni në Ballkanin Perëndimor. “Kjo shihet pikërisht në faktin se ka pasur raste kur rekomandimet e Komisionit të Venecias janë ridërguar për sqarim dhe për një opinion të dytë, me rastin e Kosovës në vitet

e fundit si shembull tipik, pikërisht për shkak se ShBA-ja në Kosovë, gjatë Qeverisë Kurti II, nuk ka treguar ndonjë interesim për ndërhyrje në çështjet e sundimit të ligjit, siç ka qenë rasti në të kaluarën”, thotë Hasani në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”. Hasani ishte përfaqësuesi i parë i Kosovës në Komisionin e Venecias të Këshillit të Evropës, kur Kosova u bë anëtare e këtij institucioni në shtator të vitit 2014. Profesor Hasani thotë se ky vendim i Uashingtonit - i cili u tërhoq edhe nga 65 organizata të

tjera ndërkombëtare që i cilësoi si “joefektive” - do t'i “inkurajojë politikanët populistë” në rajon që të dalin jashtë standardeve të sundimit të ligjit të skicuara në kornizën juridiko-kushtetuese të Komisionit të Venecias.

Sipas Hasanit, ndër ndikimet më të mëdha të pranisë së Uashingtonit në këtë institucion kishte të bënte me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Sa i rëndësishëm ka qenë në praktikë angazhimi i Shteteve të Bashkuara në Komisionin e Venecias, pavarësisht prej statusit të tyre si vëzhgues?

Enver Hasani: Ka qenë shumë i rëndësishëm, për shkak se Shtetet e Bashkuara, si një fuqi globale, jo vetëm që kanë mbështetur financiarisht punën e Komisionit, por edhe kanë pasuruar mendimet dhe raportet e Komisionit përmes ndërveprimit të vazhdueshëm që kanë pasur me trupat e tij në çështje të ndryshme juridiko-kushtetuese. Prania e ShBA-së ka qenë sinjal i efektit global të punës së Komisionit, i cili është forcuar edhe përmes ndikimit të ShBA-së nëpër botë.

Çfarë sinjali politik dërgon tërheqja e ShBA-së për qeveritë e Ballkanit Perëndimor që përballen me kritika lidhur me sundimin e ligjit, proceset zgjedhore apo reformat kushtetuese?

Enver Hasani: Një ndër ndikimet e prezencës së ShBA-së në Komisionin e Venecias ka pasur të bëjë me vendet e Ballkanit. Nuk ka kushtetutë dhe ligjistik sistemik që është nxjerrë në këto vende e që nuk ka kaluar filtrin e ekspertizës së Komisionit të Venecias. ShBA-ja, për shkak të ndikimit të madh politik në vendet e Ballkanit, ka shërbyer si një lloj garantuese në hije e zbatimit të mendimeve dhe opinioneve të Komisionit të Venecias. Deri në këtë moment që po flasim, nuk mbahet mend që ndonjëri nga vendet e Ballkanit të mos ketë zbatuar me besnikëri mendimet dhe vlerësimet e Komisionit të Venecias.

A mund ta ulë kjo presionin ndaj udhëheqësve të Ballkanit Perëndimor për t'i zbatuar rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe, nëse po, në çfarë

mënyre?

Enver Hasani: Jo domosdoshmërisht. Kjo varet nga interesi bilateral që ShBA-ja mund të ketë në rastin konkret për implementimin e ndonjë rekomandimi të Komisionit të Venecias. Si rregull, në parim, duhet thënë se tërheqja e ShBA-së e zbeh dukshëm peshën dhe rëndësinë e mendimeve dhe rekomandimeve të Komisionit të Venecias në Ballkan. Kjo shihet pikërisht në faktin se ka pasur raste kur rekomandimet e Komisionit të Venecias janë ridërguar për sqarim dhe për një opinion të dytë, me rastin e Kosovës në vitet e fundit si shembull tipik, pikërisht për shkak se ShBA-ja në Kosovë, gjatë Qeverisë Kurti II, nuk ka treguar ndonjë interesim për ndërhyrje në çështjet e sundimit të ligjit, siç ka qenë rasti në të kaluarën.

Duke pasur parasysh mbështetjen e Kosovës në opinionet e Komisionit të Venecias gjatë mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe zgjedhore, a mund të reduktojë tërheqja e ShBA-së peshën politike të këtyre opinioneve ose t'i bëjë ato më të

lehta për t'u injoruar nga aktorët vendorë?

Enver Hasani: Po. Një gjë e tillë është e pritshme dhe, siç e thashë, shenjat e para Kosova i ka dhënë gjatë viteve të fundit, kur ka ridërguar për opinion të dytë disa prej strukturave të saj normative, pavarësisht se mendimet dhe rekomandimet e Komisionit kanë qenë dukshëm të qarta. Kjo ka ndodhur, siç e thashë, pikërisht për shkak se ShBA-ja në Kosovë, gjatë mandatit të Qeverisë Kurti II, nuk ka treguar ndonjë interesim për mbështetje më aktive në çështjet e sundimit të ligjit, duke i lënë aktorët vendorë ta bëjnë punën e tyre ashtu siç dinë. Kjo përvojë dihet se si ka përfunduar, gjykuar sipas vlerësimeve ndërkombëtare që janë bërë në Kosovë gjatë këtyre viteve për sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë.

Komisioni i Venecias ka një rol këshillimor në çështjet gjyqësore dhe të sundimit të ligjit në Bosnjë-Hercegovinë, përfshirë opinionet e fundit mbi kriminalizimin e shpiffes në Republikën Sërpska dhe shqetësimet lidhur me Prokurorinë. A mendoni se një tërheqje e ShBA-së mund ta dëmtojë autoritetin ose ndikimin e Komisionit të Venecias në një shtet kaq thellësisht kompleks?

Enver Hasani: Roli i ShBA-së në zbatimin e rekomandimeve të Komisionit të Venecias është edhe më i dukshëm në Bosnje dhe Hercegovinë, edhe për faktin se ShBA-ja është garantuesja kryesore e ekzistencës fizike të Bosnje dhe Hercegovinës. Bërja shtet normal e këtij vendi as që mund të paramendohet pa vëmendjen e përhershme të ShBA-së,

pavarësisht rolit dhe peshës së madhe që ka Bashkimi Evropian. Mendimet dhe rekomandimet e Komisionit nuk kanë fuqi detyruese juridike. Ato kanë pasur ndikim të madh për shkak të ekspertizës së jashtëzakonshme të Komisionit dhe trupave të tij, si dhe ndikimit politik të ShBA-së dhe Bashkimit Evropian në vendet anëtare të Komisionit. Meqë rekomandimet e Komisionit të Venecias kanë të bëjnë me çështjet fundamentale kushtetuese, ShBA-ja ruan ndikimin e saj përmes strukturave të tjera të sigurisë, siç është NATO-ja, duke marrë parasysh faktin se anëtarësimi në këtë strukturë bazohet edhe në zbatimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë. Dihet se të gjitha vendet e Ballkanit, me përjashtim të Serbisë, kanë një entuziazëm të madh për

anëtarësim në NATO. Mirëpo, ndikimi amerikan këtu, në raport me vendimet e Komisionit, mund të ushtrohet vetëm në rastet kur administrata e ShBA-së e gjen të dobishme për interesat e saj strategjike, siç janë definuar së fundi nga administrata e presidentit amerikan, Donald Trump. Në këtë strategji të re nacionale, hemisfera perëndimore ka marrë një prioritet të madh.

Çfarë do të thotë tërheqja e ShBA-së nga Komisioni i Venecias për demokracinë dhe sundimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor?

Enver Hasani: Kjo do të thotë shumë, për faktin se Bashkimi Evropian ka ndikim të kufizuar, meqë lidhet vetëm me anëtarësimin në Bashkimin Evropian, ndërsa ndikimi

amerikan në vendet e Ballkanit Perëndimor ka qenë dhe vazhdon të jetë i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha çështjet, jo vetëm sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë. Largimi amerikan nga Komisioni i Venecias do t'i inkurajojë politikanët populistë në rajon të dalin jashtë standardeve të sundimit të ligjit dhe të qeverisjes së mirë, të skicuara në kornizën juridiko-kushtetuese të Komisionit të Venecias. Jo rrallë, kur ka pasur ngecje në implementimin e rekomandimeve të Komisionit të Venecias, ndihma amerikane ka qenë e kërkuar, veçanërisht kur ato kanë pasur të bëjnë me çështje sensitive politike që kanë prekur sigurinë dhe stabilitetin e vendeve të Ballkanit. Kjo tani nuk mund të merret si e mirëqenë.

KURTI THYEN REKORD ME MBI 400 MIJË VOTA, LV-ja FITON MBI 51 %



PRISHTINË, 8 JANAR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka shënuar rezultat historik në zgjedhjet parlamentare, duke kaluar shifrën prej 400 mijë votash individuale dhe duke u renditur kandidati më i votuar ndonjëherë në Kosovë. Sipas të dhënave më të fundit të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 8 janar 2026, në orën 09:36, kreu i Lëvizjes Vetëvendosje ka grumbulluar gjithsej 401 241 vota, ndërsa partia që drejton ka sigu-

ruar shumicën absolute të votave, me 51.01 për qind apo 484 049 vota, pas numërimit të 100 për qind të vendvotimeve, gjithsej 2 836. Duke shikuar nga historiku i zgjedhjeve në Kosovë, Kurti është bërë kandidati më i votuar, duke kaluar edhe presidentin historik, Ibrahim Rugova, që kishte marrë 359 851 vota në vitin 2001. Kryetari i LV-së ishte votuar në masë të madhe edhe më 9 shkurt 2025, ku kishte marrë 337

791 vota, ndërsa Glauk Konjufca ishte votuar në 315 300 sosh. Mbi 300 mijë vota kishte marrë edhe Vjosa Osmani, presidentja aktuale e vendit, saktësisht 300 756 sosh në vitin 2021. Kur jemi te partitë, pas Vetëvendosjes, renditja e subjekteve politike vijon me Partinë Demokratike e Kosovës, e cila ka marrë 20.24 për qind të votave, e ndjekur nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 13.26 për qind, si dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 5.50 për qind.

Bazuar në këto rezultate preliminare, shpërndarja e ulëseve në Kuvendin e Kosovës parasheh që LV-ja të ketë 57 mandate, PDK-ja 22, LDK-ja 15, AAK-ja 6, ndërsa 20 ulëse u takojnë përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë. Sa i përket pjesëmarrjes në zgjedhje, sipas KQZ-së, në procesin zgjedhor kanë marrë pjesë 45.03 për qind e votuesve, përkatësisht 900 330 qytetarë nga gjithsej 1 999 204 votues sa ishin të regjistruar në Listën Votuese brenda vendit.

Ndërkohë, 77 086 qytetarë ishin të regjistruar për votim jashtë Kosovës. Procesi zgjedhor brenda Kosovës është zhvilluar në 948 qendra të votimit, me gjithsej 2 614 vendvotime, përfshirë votimin e rregullt dhe atë me kusht. Ndërkaq, votimi jashtë vendit është organizuar më 27 dhjetor në 29 përfaqësi diplomatike të Kosovës, të vendosura në 18 shtete, ku të drejtë vote kanë pasur 19 187 votues të regjistruar.

KUR KALENDARI KRIJON AVANTAZH POLITIK DHE KUR OPOZITA SILLET ME INDOLENCË DHE KEQLEXIM



Shkruan: Ibrahim GASHI

Caktimi i datës së zgjedhjeve përbën një element thelbësor të dizajnit elektoral dhe ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes, strukturën e elektoratit dhe balancën konkurruese mes aktorëve politikë. Rasti i zgjedhjeve të mbajtura më 28 dhjetor në Kosovë ofron një shembull ilustrues të mënyrës se si faktori kohë mund të shndërrohet në avantazh politik me efekte të matshme në rezultat. Periudha e fundvitit karakterizohet nga kthimi masiv i diasporës kosovare në vend, kryesisht për arsye familjare dhe kulturore. Sipas të dhënave zgjedhore dhe vlerësimeve të institucioneve përkatëse, në këto zgjedhje kanë votuar në Kosovë më shumë se 100.000 qytetarë të ardhur nga diaspora, me vlerësime që e çojnë këtë shifër deri në rreth 140.000 votues. Ky është një kontingjent numerikisht i konsiderueshëm, i cili, në një sistem proporcional si ai i Kosovës, ka potencial real për ta ndryshuar ndjeshëm shpërndarjen e mandateve. Sipas të gjitha burimeve relevante dhe analizave

paszgjedhore, shumica dërrmuese e këtij kontingjenti votues e ka orientuar votën e saj drejt Lëvizjes Vetëvendosje (VV). Në aspektin strikt numerik, kjo nënkupton se pikërisht vota e diasporës së pranishme fizikisht në Kosovë ka qenë faktori vendimtar që ka prodhuar ndryshimin e ndjeshëm në rezultatin final zgjedhor. Pra, nuk kemi të bëjmë vetëm me një prirje politike, por me një efekt konkret dhe të matshëm elektoral. Në këtë kontekst, vendosja e zgjedhjeve në një moment kur diaspora ndodhej në vend nuk mund të shihet si neutrale. Nga perspektiva e teorisë së dizajnit institucional dhe menaxhimit të avantazhit elektoral, ky vendim përfaqëson një strategji të qëllimshme të shfrytëzimit të një strukture të favorshme votuesish. Partia dominuese, duke u mbështetur në matje të sakta të preferencave elektorale të diasporës, arriti ta përkthejë praninë fizike të saj në kapital politik konkret. Nëse vendimi për mbajtjen e zgjedhjeve më 28 dhjetor mund të interpretohet si një strategji e sofistikuar e partisë

dominuese, atëherë pranimi i kësaj date nga partitë opozitare përbën një dështim të shumëfishtë politik dhe strategjik. Ky dështim nuk ishte i rastësishëm, as i imponuar nga rrethana të pakontrollueshme, por rezultat i një keqleximi serioz të realitetit elektoral dhe i mungesës së kapacitetit analitik për të parashikuar pasojat e këtij vendimi. Opozita kishte në dispozicion të gjitha të dhënat e nevojshme për ta kuptuar ndikimin e diasporës në rezultatin zgjedhor: trendet e mëparshme të votimit, matjet e opinionit publik dhe strukturën e mbështetjes politike të subjekteve kryesore. Megjithatë, ajo dështoi ta trajtojë këtë informacion si bazë për veprim politik. Pranimi i datës 28 dhjetor, pa asnjë përpjekje serioze për ta kontestuar atë në plan institucional, publik apo mediatik, përfaqëson një formë të kapitullimit të heshtur përpara se gara të fillonte. Ky veprim - ose më saktë, kjo mungesë veprimi - e zhvesh opozitën nga roli i saj themelor në një demokraci funksionale:

garantimin e konkurrencës së barabartë. Në vend që të kërkonte një datë alternative më neutrale, opozita u tregua e paaftë të ndërtojë një qëndrim të përbashkët, duke reflektuar fragmentim të brendshëm, mungesë lidheshi dhe frikë nga konfrontimi politik. Kjo sjellje nuk është thjesht gabim taktik; ajo është simptomë e një krize më të thellë strukturore brenda opozitës kosovare. Edhe më problematik është fakti se opozita dështoi të artikulojë publikisht pasojat e këtij vendimi. Në një kontekst ku mbi 100.000, e sipas vlerësimeve deri në 140.000 votues nga diaspora ishin të pranishëm në Kosovë dhe ku shumica dërrmuese e tyre votoi për një subjekt të vetëm politik, heshtja e opozitës përbën një formë të vetëpërrjashtimit nga debati politik. Duke mos e problematizuar këtë realitet para elektoratit, opozita humbi edhe mundësinë minimale për ta sensibilizuar opinionin publik mbi pabarazinë faktike të garës. Për më tepër, opozita nuk arriti të kompensojë këtë disavantazh as përmes mobilizimit të elektoratit vendor. Periudha festive, e

njohur për uljen e interesimit politik dhe pjesëmarrjes kritike, kërkonte strategji të jashtëzakonshme mobilizimi dhe komunikimi. Në vend të kësaj, partitë opozitare u shfaqën me fushata të zbehta, mesazhe të paqarta dhe mungesë narrative politike bindëse, duke e lënë terrenin elektoral pothuajse të lirë për partinë në pushtet. Në literaturën mbi konkurrencën demokratike, një opozitë e tillë përkufizohet si “reaktive” dhe jo “strategjike”: ajo reagon ndaj rrethanave pasi ato kanë prodhuar efektin, por nuk arrin t’i parandalojë apo t’i formësojë ato. Rasti i zgjedhjeve të 28 dhjetorit e konfirmon këtë përkufizim. Opozita jo vetëm që humbi zgjedhjet, por dështoi edhe ta sfidojë mënyrën se si ato u dizajnuan. Në këtë kuptim, humbja elektorale e opozitës nuk mund t’i atribuohet vetëm epërsisë së kundërshtarit, por mbi të gjitha paaftësisë së saj për të kuptuar se politika moderne nuk zhvillohet vetëm në fletën e votimit, por edhe në kontrollin e kohës, rregullave dhe kontekstit të garës. Pranimi i datës 28 dhjetor ishte jo thjesht një gabim, por një akt vetë-dëmtues strategjik, pasojat e të cilit u reflektuan drejtpërdrejt në rezultatin final. Për më tepër, periudha festive ndikoi edhe në cilësinë e debatit publik, duke e zhvendosur fokusin nga garat programore drejt mobilizimit emocional dhe identitar. Në literaturën mbi pjesëmarrjen elektorale, këto kushte zakonisht favorizojnë partitë me bazë të gjerë mbështetëse dhe me narrative të konsoliduar politike, çka në rastin konkret e forcoi edhe më shumë pozitën e VV-së. Në përfundim, zgjedhjet e 28 dhjetorit dëshmojnë se dimensionin kohor i procesit zgjedhor, i kombinuar me strukturën e elektoratit, mund të prodhojë efekte vendimtare në rezultat. Prania e mbi 100.000 votuesve nga diaspora dhe orientimi i tyre i qartë politik nuk ishte thjesht një faktor dytësor, por elementi kyç që e ndryshoi balancën zgjedhore. Ky rast përbën një mësim të rëndësishëm për aktorët politikë në Kosovë: në një demokraci konkurruese, koha, numrat dhe njohja e elektoratit janë po aq të rëndësishme sa programet politike.

Komuna e Rahovecit jep 600 euro për çdo lindje, Latifi nënshkruan vendimin

Prishtinë, 8 janar - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar vendimet e para për subvencionimin e dy lindjeve në Qendrën

Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec. Nga janari i këtij viti çdo lindje e realizuar në repartin e

maternitetit të QKMF-së “Dr. Fahredin Hoti” do të mbështetet nga komuna e Rahovecit me 600 euro, nga 500 euro sa ishte më parë,

ndërsa deri në fund të mandatit, në përputhje me zotimin e dhënë, subvencionimi do të rritet në 750 euro.



BËHET APEL PËR KUJDES NË TRAFIK PAS RESHJEVE TË BORËS NË KOSOVË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 JANAR - Autoritetet në Kosovë kanë bërë thirrje për kujdes në trafik pas rënies së temperaturave dhe reshjeve të borës.

Mbrëmjen e së mërkurës Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) paralajmëroi rënie të temperaturave, që tha se pritet të shkaktojnë ngrica nëpër rrugët e Kosovës.

Ushtruesi i detyrës së ministrit të Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ka njoftuar se pas reshjeve të borës, të gjitha rrugët në Kosovë janë të

kalueshme, por bëri thirrje për kujdes të shtuar gjatë qarkullimit. “Gjatë gjithë natës kemi intervenuar në shumicën e rrugëve që janë në kompetencë të ministrisë. Edhe sot në mëngjes kemi vazhduar punën në pastrimin e rrugëve dhe hedhjen e kripës”, ka shkruar ai në “Facebook”.

Policia e Kosovës u bëri thirrje qytetarëve që të kenë kujdes në trafik. Ky institucion apeloj shoferët që ta përshtatin shpejtësinë me kushtet atmosferike dhe gjendjen në rrugë, ta mbajnë distancën me automjete të tjera, për shkak të mundësisë së ngricave. “Siguria

juaj është prioritet. Kujdesi i shtuar ndihmon në shmangien e aksidenteve dhe ruajtjen e jetës”, tha Policia përmes një njoftimi në rrjetet sociale.

Rënia e temperaturave vjen pas vërshimeve shkatërruese në disa pjesë të Kosovës.

Ndërkohë, kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, i luti qytetarët ta shmangin udhëtimin me automjete në orët në vijimin për shkak të ngricave të mundshme nëpër rrugë.

Në një njoftim në “Facebook”, IHMK-ja tha në orët në vijim pritet të bjerë borë dhe era do të fryjë në drejtim të veriut dhe

veriperëndimit, e shoqëruar nga një rënie e madhe e temperaturave në të gjithë Kosovën.

“Temperaturat minimale do të shënojnë ulje të theksuar, duke zbritur nën vlerat zero gradë celsius, veçanërisht gjatë natës dhe orëve të hershme të mëngjesit. Kjo do të krijojë kushte të favorshme për formimin e ngricave në sipërfaqet rrugore, trotuare, ura dhe zona të ekspozuara ndaj lagështisë së lartë”, ka njoftuar ky institut.

Ngricat, të kombinuara me shtresat e borës dhe erërat e ftohta, pritet të ndikojnë negativisht në sigurinë e

qarkullimit rrugor, paralajmëroi IHMK.

Këto paralajmërimë vijnë një ditë pasi vendi u përball me vërshime të mëdha, të cilat detyruan gjithashtu autoritetet ta shtyjnë për 12 janar rifillimin e mësimit pas pushimit dimëror, i cili duhej të riniste të enjten.

Reshjet e mëdha në ditët e fundit sollën përmytje duke shkaktuar dëme në prona dhe infrastrukturë, evakuime, telashe me ujin e pijes, si dhe bllokim rrugësh të martën.

Moti i lig nuk ka shkakuar viktima apo të lënduar, thanë autoritetet të mërkurën.



AKSION I GJERË I PROKURORISË NË KOSOVË: 39 PERSONA TË ARRESTUAR, BKS-ja THOTË SE KA DENONCUAR SHKELJET

PRISHTINË, 8 JANAR - Krimet ekonomike të Policisë së Kosovës e kanë kryer të enjten një aksion të gjerë në gjithë vendin lidhur me dyshimet se u janë shkakuar dëme Byrosë Kosovare të Sigurimeve.

Prokuroria Themelore në Prizren tha në një konferencë për medie se aksioni i së enjtes kishte në shënjestër 46 persona dhe përfundoi me arrestimin e 39 prej tyre.

Aksioni është zhvilluar në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Prokuroria bëri me dije se janë siguruar 166 transaksione të dyshimta.

E lidhur me këto bastisje ka reaguar Byroja Kosovare e Sigurimeve.

Byroja Kosovare e Sigurimeve tha se sa i përket këtij aksioni ai është iniciuar nga vetë byroja në cilësinë e palës së dëmtuar “rezultat i konstatimeve të identifikuar në raportin e Auditimit të Brendshëm”. “Byroja Kosovare e Sigurimeve



(BKS) njofton opinionin publik se rasti i fundit, i cili po trajtohet nga Prokuroria Themelore në Prizren dhe për të cilin janë raportuar bastisje dhe veprime hetimore, është iniciuar nga vetë BKS-ja në cilësinë e palës së dëmtuar, si rezultat i konstatimeve të identifikuar në raportin e Auditimit të Brendshëm. Në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm të Byrosë për transparencë, integritet institucional dhe

mbrojtje të interesit publik, pas evidentimit të shkeljeve serioze dhe dyshimeve për keqpërdorime, BKS ka ndërmarrë veprime të menjëhershme ligjore, duke i adresuar gjetjet përkatëse tek organet kompetente të rendit dhe drejtësisë, thuhet në reagimin e BKS-së, duke theksuar se do të vazhdojnë të bashkëpunojnë në mënyrë të plotë dhe aktive me Prokurorinë dhe Policinë e Kosovës, duke

vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për zhvillimin e hetimeve.

“Theksojmë se BKS mbetet e përkushtuar në forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, parandalimin e keqpërdorimeve dhe garantimin e menaxhimit të përgjegjshëm të mjeteve financiare, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Byroja Kosovare e Sigurimeve rithekson se respekton parimin e prezumimit të pafajësisë dhe beson se organet e drejtësisë do ta zbardhin plotësisht këtë rast, duke vepruar në përputhje me ligjin. Për çdo zhvillim të mëtejshëm, opinionin publik do të njoftohet në kohë përmes kanaleve zyrtare të Byrosë”, është theksuar në reagimin e BKS-së. “Betimi për Drejtësi”, ueb-faqe e specializuar për fushën e sundimit të ligjit, duke u thirrur në burimet e saj, ka raportuar se gjatë aksionit janë arrestuar disa

persona në rajonet e Prizrenit, Prishtinës, Pejës, Gjilanit, Ferizajt, Mitrovicës dhe Gjakovës.

Në mesin e të arrestuarve, sipas “Betimit për Drejtësi”, janë Sami Mazreku, ish-drejtor i Byrosë Kosovare të Sigurimeve dhe ish-drejtori i Financave i kësaj byroje, Valon Berisha. Ata dyshohen se u kanë lëshuar para qytetarëve të ndryshëm në emër të sigurimeve, në vlerë prej mijëra eurosh. Ky medium mëson se nga këto para, qytetarët një pjesë të tyre dyshohet t’ua kenë dhënë atyre në para të gatshme.

Raportohet se aksioni po zhvillohet lidhur me dyshimet për kryerjen e veprave penale: “keqpërdorim i besimit”, “keqpërdorim i autorizimeve ekonomike”, “ndihmë në keqpërdorim të besimit” dhe “falsifikim të dokumentit”.

Në këtë aksion thuhet se janë përfshirë një numër i madh i prokurorëve dhe policëve.

PA KARTELË, ME EURO NË DORË: SI E DËMTOJNË PAGESAT ME PARA TË GATSHME BUXHETIN E KOSOVËS?

PRISHTINË, 8 JANAR - Arben Musliu nga Fushë-Kosova e përdor kartelën bankare vetëm një herë në muaj: kur tërheq pagën mujore. Të gjitha pagesat, qoftë për shërbime komunale apo për blerje në dyqane, 48-vjeçari i realizon me para të gatshme, pa marrë parasysh vlerën. Madje para tre vjetësh ai pagoi 5 000 euro para të gatshme për ta ndërruar veturën e tij me një më të re. “Nuk i besoj tërheqjes së shpeshtë të parave nga bankomatët. Paratë në kuletë i menaxhoj më lehtë. Edhe kursimet i mbaj në shtëpi, jo në bankë. Nuk kam ndonjë arsye konkrete, por thjesht nuk besoj... nuk besoj”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë (REL).

Ndryshe nga Arbeni, Besarta, 23-vjeçare, pohon se të gjitha blerjet dhe pagesat e shërbimeve i kryen në formë elektronike. “Bëhem nervoz kur nuk ka POS [aparate për kryerje të pagesës me kartelë] në dyqane, sepse nuk mbaj para në kuletë”, shprehet ajo për REL-in, duke shtuar se me këtë problem përballet kryesisht në biznese më të vogla, që shpeshherë nuk lëshojnë as kuponë fiskalë.

Shumë qytetarë dhe biznese vazhdojnë t'i përdorin paratë e gatshme më shumë, pasi që paratë fizike e shohin si “më të sigurt”, thonë ekspertë të ekonomisë. Por, sipas tyre, të rinjtë bëjnë përrjashtim.

Sipas Bankës Botërore, vetëm 76 për qind e të rriturve në Ballkanin Perëndimor kanë një llogari transaksionesh, në krahasim me 99 për qind të të rriturve në Eurozonë. Por, këto pagesa me para të gatshme nuk regjistrohen dhe nuk monitorohen nga autoritetet fiskale, pasi nuk lënë gjurmë elektronike, thotë profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Mejdi Bektashi. Sipas tij, kjo formë e pagesave jashtë kanaleve bankare i shkakton humbje buxhetit të shtetit përmes shmangies nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh), tatimi mbi paga dhe tatimi mbi fitimin, dhe lehtëson shitjen e produkteve pa kupon fiskal. Bektashi merr si shembull rastin



kur një person paguan 5 000 euro me para të gatshme, duke theksuar se në këtë rast shteti humb 900 euro, sa i bie të jetë 18-përqindëshi i TVSh-së. “Heqja e parasë së gatshme, përveç që ndikon fuqishëm në eliminimin apo zvogëlimin në minimum të ekonomisë joformale, ndikon edhe në zvogëlimin e fenomeneve të dëmshme, siç janë korrupsioni, ryshfeti dhe shumë fenomene të tjera”, thekson Bektashi për Radion Evropa e Lirë.

Nëse shteti do të arrinte t'i mblidhte të gjitha tatimet, Bektashi konsideron se buxheti i vitit 2026 do të arrinte në rreth pesë miliardë euro, sepse do t'i shtoheshin rreth një miliard euro më shumë nga TVSh-ja dhe tatimet e tjera.

Dhe, kjo shumë do të mund të përdorej për investime kapitale. Qeveria në detyrë e Kosovës e ka miratuar buxhetin për vitin 2026, që kap shifrën e rreth katër miliardë eurosh.

Në një raport të Bankës Botërore thuhet se nëse një vend shënon rritje për 10 për qind të pagesave digjitale, ekonomia joformale e atij vendi ulet për rreth 2 për qind si rrjedhojë.

Edhe Banka Qendrore e Kosovës

(BQK) vlerëson se ekonomia joformale ndikon drejtpërdrejt në rritjen e përdorimit të parasë së gatshme, pasi që bizneset informale preferojnë transaksione të pagjurmueshme për t'i shmangur detyrimet fiskale. “Të dhënat e vitit të kaluar tregojnë se vërehet një tendencë pozitive e rritjes së transaksioneve përmes kanaleve digjitale. Megjithatë, sfida mbetet mungesa e besimit dhe edukimit financiar”, thuhet në një përgjigje nga BQK-ja për REL-in.

Për këtë arsye, BQK-ja thotë se synon forcimin e sigurisë dhe besimit në sistemet e pagesave, si dhe zgjerimin e përdorimit të pagesave digjitale.

Ekonomia joformale, mbi 30 për qind e PBB-së

Instituti Riinvest në vazhdimësi përcjell nivelin e informalitetit përmes anketimit të bizneseve. Në raportin “Zhvillimet ekonomike: Kërcënimet nga kriza institucionale”, publikuar në nëntor të vitit të kaluar, thuhet se informaliteti në Kosovë sillet nga 30 deri në 35 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto

(PBB). PBB-ja për vitin 2025 ishte mbi 11 miliardë euro.

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) nuk është përgjigjur në pyetjen e REL-it se sa është vlera e ekonomisë joligjore. Por, drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Mentor Hyseni, tha më 22 dhjetor, gjatë një konference vjetore, se ky institucion ka mbledhur mbi një miliard euro më 2025, duke shënuar rritje prej 11-përqindësh krahasuar me vitin e kaluar. Rreth 49 për qind ishin të hyra nga TVSh-ja.

Profesori Bektashi shprehet se autoritetet kompetente duhet të angazhohen që përdorimi i parasë digjitale të rritet në të gjithë sektorët, pasi është thelbësor për modernizimin e ekonomisë dhe uljen e ekonomisë joformale.

Labinot Haxhiu, udhëheqës i Bankingut Digjital në bankën TEB, përmend rëndësinë e adoptimit të shërbimeve financiare nga brezat e rinj, për të cilët bankingu duhet të jetë po aq i lehtë sa rrjetet sociale, dhe po aq i menjëhershëm sa aplikacionet e mesazheve. “Të rinjtë në Kosovë jetojnë online. Për ta, bankingu nuk lidhet me sportele dhe pritje në radhë, por

me përvoja digjitale intuitive, të qasshme dhe të personalizuara”, ka shkruar ai në revistën financiare “Bankieri i Kosovës 2025-2026”, publikuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës.

Në Kosovë operojnë dhjetë banka komerciale. Numri i kartelave debit në vitin 2024 kishte arritur në 1.4 milion, kurse i kartelave të kreditit në rreth 195 mijë.

Në nivel vendi janë 635 bankomatë [aparate bankare për tërheqje të parave], dhe 20.913 terminale POS, ku qytetarët mund të bëjnë pagesa me kartelë në dyqane.

Paraja e gatshme vazhdon të jetë e përhapur edhe në rajon, ndonëse përdorimi i saj është në rënie. Serbia kryeson në Ballkanin Perëndimor për sa i përket adoptimit të pagesave pa para fizike.

Ndërkaq, Shqipëria synon që deri në fund të vitit 2030 t'i bëjë të gjitha transaksionet financiare në formë digjitale.

Atje tashmë ka filluar një nismë kombëtare që synon ta rrisë përdorimin e pagesave digjitale nga qytetarët dhe bizneset, duke ndërtuar një infrastrukturë moderne, të sigurt dhe funksionale.

95 % e ekonomive familjare janë pronare të shtëpive ose banesave me akt ligjor



PRISHTINË, 8 JANAR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (SILC) për vitin 2024. Sipas rezultateve të kësaj ankete, sa i përket shkallës së pronësisë së shtëpive dhe banesave: 95 % e ekonomive familjare kishin në pronësi me akt ligjor shtëpitë/banesat; 1,7 % e ekonomive familjare ishin qiramarrës ose nënqiramarrës që paguanjë qira me normën e

tregut; ndërsa për 3,2 % të ekonomive familjare, akomodimi ofrohet falas. Rreth 88,6 % e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se jetojnë në shtëpi të veçuar, të ndarë në vete; 2,8 % e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se jetojnë në shtëpi gjysmë të ndarë, dy banesa; 2,1 % e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se jetojnë në ndërtesa me më pak

se 10 banesa; ndërsa 6,4 % e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se jetojnë në ndërtesa me më shumë se 10 banesa. Rreth 78,4 % e ekonomive familjare ishin në gjendje ta përballojnë mbajtjen e shtëpisë të ngrohtë në mënyrë adekuate; përderisa për 21,6 % të ekonomive familjare ishte e papërballueshme mbajtja e shtëpisë ngrohtë në mënyrë adekuate.

TAKIMET SEKRETE QË TREGOJNË SE RRËZIMI I MADUROS NDODHI (EDHE) NGA BRENDA...

Një anëtar i lartë i familjes mbretërore të Emirateve të Bashkuara Arabe ka vepruar si ndërmjetës në bisedimet mes Donald Trumpit dhe presidentes së përkohshme




Në një sallë takimesh në Doha, rreth 7.500 milje larg Karakasit, disa zyrtarë po diskutonin të ardhmen e Venezuelës pa Nicolás Maduro-n, diktatorin e saj. Një anëtar i lartë i familjes mbretërore të Emirateve të Bashkuara Arabe vepronte si urë lidhëse mes regjimit dhe Donald Trump-it, ndërkohë që presidenti amerikan po ndërtonte një “ushtri”, për t’i bërë presion udhëheqësit venezuelian që të dorëzohej. Por Maduro nuk ishte pjesë e takimeve sekrete në Doha. Në vend të tij, ishin zëvendëspresidentja Delcy Rodríguez, dhe vëllai i saj, Jorge Rodríguez, ata që udhëhiqnin bisedimet. Sipas Miami Herald, që ka lidhje të forta në Amerikën Latine, zonja Rodríguez i ishte drejtuar Uashingtonit për t’u paraqitur si një alternativë “më e pranueshme” ndaj regjimit të Maduro-s. Sot, ajo qeveris Venezuelën me miratimin e Trumpit. Detajet e takimit kanë ushqyer dyshimet se largimi i Maduro-

s ishte një operacion i brendshëm, i planifikuar për të lënë në pushtet një presidente që mund të menaxhojë tranzicionin, pa e shpërbërë plotësisht shtetin dhe pa shkaktuar kaos apo trazira. Siç thuhej në raportimet e tetorit për takimin, zonja Rodríguez ofronte “madurizëm pa Maduron”, një lloj “regjimi të lehtësuar”. Të shtunën, Donald Trumpi deklaroi se SHBA do ta “drejtonte” Venezuelën gjatë tranzicionit përmes qeverisë së përkohshme të drejtuar nga Rodríguez, ndërkohë që po bëheshin përgatitje që kompanitë amerikane të naftës të hynin dhe të nisnin nxjerrjen. “Ajo është në thelb e gatshme të bëjë atë që ne mendojmë se është e nevojshme për ta bërë Venezuelën sërish të madhe,” u tha Trump gazetarëve për zonjën Rodríguez, e cila ishte sanksionuar nga SHBA gjatë mandatit të parë të Trumpit, për rolin e saj në minimin e demokracisë venezueliane.

Të dielën, Francisco Santos Calderón, ish-zëvendëspresident i Kolumbisë, sugjeroi se i gjithë operacioni për largimin e Maduro-s kishte qenë një punë nga brenda, me ndihmën e zonjës Rodríguez. Santos tha se ishte “absolutisht i sigurt” se Rodríguez e kishte tradhtuar Maduron duke lejuar kapjen e tij nga SHBA pa shumë rezistencë. “Ndaj nuk e rrëzuan, por ia dorëzuan,” tha ai. “Jam absolutisht i bindur se Delcy Rodríguez e dorëzoi. Të gjitha informacionet që kemi, kur i bashkon, të çojnë në përfundimin se ky ishte një operacion ku ai u dorëzua. Sigurisht që duhej përgatitur skena. Presidenti Trump thotë se Delcy do të jetë ajo që do të udhëheqë tranzicionin, pra Delcy do ta drejtojë tranzicionin. Ajo është shumë e qartë për rolin që do të luajë dhe do të përpiqet të fitojë pak pavarësi.” Në të vërtetë, Rodríguez, një avokate 56-vjeçare me lidhje

me industrinë e naftës, duket si një kandidate ideale për të bashkëpunuar me SHBA. Ajo ka shërbyer si zëvendëspresidente e Maduro-s që nga viti 2018. Ajo hyri në qeveri menjëherë pas zgjedhjes së Hugo Chávezit në vitin 1999 dhe u ngjiti gradualisht në hierarki. Ka shërbyer si ministre e Jashtme, kryetare e Asamblesë Kushtetuese dhe, gjatë kohës si zëvendëspresidente, ka mbajtur edhe postet e ministres së Naftës dhe të Financave. Në rolin e saj të fundit, Rodríguez arriti të ruajë profilin e saj të majtë, duke u bërë njëkohësisht “fytyra e një liberalizimi relativ ekonomik”, sipas Geoff Ramsey, ekspert për Amerikën Latine në Atlantic Council. Këto politika miqësore ndaj tregut ndihmuan nxjerrjen e Venezuelës nga kriza e thellë ekonomike që zgjati deri në vitin 2021, gjatë së cilës ekonomia u tkurr me tre të katërtat dhe pothuajse tetë milionë njerëz u detyruan të

largoheshin nga vendi. Ky sukses i siguroi asaj jo vetëm pëlqimin e Maduro-s, por edhe të një pjese të rëndësishme të biznesit vendas të lidhur me qeverinë, sipas Pedro Garmendias, analist venezuelian i riskut politik dhe gjeopolitikës. “Ata kanë filluar ta shohin si një figurë të parashikueshme dhe efektive,” tha ai, duke iu referuar sektorëve privatë që tashmë e shohin Rodríguezin si aleatë. Ajo mund të mbështetet edhe në historinë familjare si dëshmi revolucionare. Babai i saj dikur udhëhoqi një operacion për rrëmbimin e një biznesmeni amerikan, si pjesë e një grupi gueril komunist që e akuzonte atë si agjent të CIA-s. Vëllai i saj Jorge është një tjetër figurë e rëndësishme e sistemit dhe aktualisht kryeson legjislaturën e vendit. Ajo dhe vëllai i saj, i cili ka qenë figurë qendrore në përpjekjet e fundit negociuese me SHBA-në, janë bërë “dyshja



e fuqishme” e regjimit, sipas Garmendias.

“Të dy kanë mësuar të jetojnë dhe të mbijetojnë nën presionin dhe sanksionet amerikane,” tha ai. Megjithatë, edhe me këto kredenciale, Rodríguez përballet tani me detyrën e vështirë të mbajtjes së koalicionit dhe shmangies së perceptimit të brendshëm si “vegël e SHBA-së”, tha Ramsey, veçanërisht përballë rivalëve brenda kampit qeverisës që mund të shfrytëzojnë çdo dobësi. “Mbajtja e të gjithëve të bashkuar nuk do të jetë e lehtë. Deri tani ajo duket se po ia del,” tha ai, “por mund të supozojmë se brenda partisë qeverisëse situata nuk është aspak e qetë.”

Trump ndoshta nuk e ndihmoi situatën të shtunën, kur pretendoi se zonja Rodríguez kishte folur me Marco Rubion, sekretarin amerikan të Shtetit, dhe kishte ofruar të bënte “çfarëdo që SHBA të kishte nevojë”.

Përpjekjet e Rodríguez për të “menaxhuar perceptimin” brenda vendit dhe për t’u dukur sikur po i reziston presionit amerikan, mund të shpjegojnë deklaratat fillestare kontradiktore mes Trumpit dhe Rodríguezit, tha Ramsey.

Stil konfrontues

Rodríguez ka përqafuar një stil konfrontues në rolet e saj

publike, pa patur frikë të sulmojë hapur kundërshtarët. Pas përjashtimit të Venezuelës nga blloku tregtar Mercosur në vitin 2016, ajo u përpoq gjithsesi të merrte pjesë në një nga mbledhjet e tij në Buenos Aires. “Mbylleni derën për ne dhe ne do të hyjmë nga dritarja,” u tha ajo gazetarëve, pasi arriti për pak çaste të kalonte sigurinë dhe të futej në godinë.

Gjatë konferencës për shtyp të së shtunës, Trumpi nuk e specifikoi se për sa kohë e parashikonte Rodríguezin në krye të vendit. “Askush nuk do të marrë pushtetin. Ata kanë një zëvendëspresidente, e zgjedhur nga zoti Maduro, e cila aktualisht është zëvendëspresidente dhe, mendoj, tani është presidente,” tha ai.

Në një intervistë të mëvonshme për New York Post, Trump tha se nuk do të dërgonte trupa në Venezuelë nëse Rodríguez bënte atë që ai dëshironte.

Ajo që Trump dëshiron realisht për Venezuelën mbetet e paqartë. Nëse Rodríguez do të pajtohet me dëshirat e tij, kjo mund të varet nga cila anë e identitetit të saj politik do të mbizotërojë: besnikja revolucionare apo ndërmjetësja pragmatike e pushtetit.

Marrja e pushtetit nga Rodríguez ishte një nga dy opsionet që iu paraqitën

SHBA-së nga ndërmjetësit nga Katar, raportoi Miami Herald, duke cituar burime anonime; opsioni tjetër ishte Miguel Rodríguez Torres, një gjeneral në pension që aktualisht ndodhet në mërgim.

Mendohet se Rodríguez ka një “marrëdhënie të rëndësishme” me anëtarë të familjes mbretërore të Katarit dhe fsheh disa nga asetet e veta në atë vend, gjë që e bëri Dohën një zgjedhje të natyrshme si ndërmjetëse mes saj dhe SHBA-së.

Gjatë një takimi në kryeqytetin e Katarit, një anëtar i lartë i familjes mbretërore pranoi se po vepronin si urë lidhëse mes Karakasit dhe Uashingtonit në çështje që lidhen me “bashkëpunimin e inteligjencës dhe ekonomisë”, raportoi Miami Herald.

Propozimet për “madurizëm pa Maduron” iu paraqitën Shtëpisë së Bardhë nga Richard Grenell, një nga të dërguarit specialë të Trumpit, i cili u takua me Maduron në janar të vitit të kaluar.

Një plan fillestar, i paraqitur në prill, parashikonte që Maduro të largohej nga pushteti, të qëndronte në Venezuelë dhe t’u jepte kompanive amerikane akses në naftën venezueliane. Në këmbim, SHBA do të hiqte akuzat penale kundër presidentit venezuelian dhe Rodríguez do të merrte drejtimin.

Por ky propozim nuk u

realizua, pasi Rubio argumentoi se SHBA nuk duhej të pranonte asgjë më pak se ndryshim regjimi. Një propozim i dytë, i paraqitur në shtator, sugjeronte që Rodríguez të drejtonte një qeveri tranzicioni, ndërsa Maduro të kërkonte azil në Katar ose Turqi.

Edhe ky propozim u refuzua nga SHBA, e cila besonte se strukturat kriminale të regjimit thjesht do të riformatoheshin nën një udhëheqje të re. “Karteli i lehtësuar nuk ishte një opsion i pranueshëm,” tha një burim. Raportimet për takime mes ekipit të Rodríguezit dhe amerikanëve u zbehën drejt fundit të vitit. Ndërkohë, ndërmjetësit e siguruan administratën Trump se ajo do të promovonte investimet energjetike amerikane, duke e bërë atë një zgjedhje të lehtë për të drejtuar të paktën një qeveri tranzicioni. “E kam ndjekur karrierën e saj prej kohësh, ndaj kam një ide të qartë se kush është dhe çfarë përfaqëson,” i tha New York Times një zyrtar i lartë amerikan.

“Nuk po pretendoj se ajo është zgjidhja përfundimtare e problemeve të vendit, por padyshim është dikush me të cilën mendojmë se mund të bashkëpunojmë në një nivel shumë më profesional sesa kemi mundur me të,” shtoi zyrtari, duke iu referuar


Maduros.

Megjithatë, zyrtarët amerikanë thanë se marrëdhënia e tyre me qeverinë e përkohshme do të varet nga fakti nëse Rodríguez do të veprojë sipas rregullave të tyre dhe paralajmëruan se mund të ndërmarrin veprime të tjera ushtarake nëse ajo nuk respekton interesat amerikane.

Të shtunën në mbrëmje, Rodríguez u shfaq në televizionin shtetëror dhe mbajti një ton sfidues. “Ne kërkojmë lirimin e menjëhershëm të Presidentit Nicolás Maduro dhe bashkëshortes së tij, Cilia Flores,” tha ajo.

Trump duket se e ka lënë mënjanë María Corina Machado, lideren e opozitës venezueliane që fitoi Çmimin Nobel për Paqe vitin e kaluar. Trump tha se zonja Machado nuk kishte mbështetjen e nevojshme në vend për të marrë pushtetin pas Maduros, duke zhgënjyer mbështetësit e saj.

Raportimet sugjeruan se ekipi i saj nuk arriti ta bindte Uashingtonin se kishte kapacitetin për të marrë kontrollin e aparatit shtetëror, kryesisht për shkak se nuk kishte mbështetjen e ushtrisë venezueliane. / *The Telegraph* – *bota.al*



Ish-futbollisti i Kosovës mund ta marrë drejtimin e skuadrës austriake

VJENË, 8 JANAR - Pas largimit të trajnerit Fabio Ingolitsch, Altachu ende nuk ka paraqitur trajner të ri. Stërvitjen e parë këtë vit e ka udhëhequr ish-sulmuesi i Kosovës, Atdhe Nuhii, i cili ishte asistent i Ingolitschit. Ai javën e

kaluar është emëruar trajner i Sturm Grazit. "Sky" ka raportuar se Nuhii është option për ta drejtuar Altachun si trajner i parë. Më herët në mediumet austriake është raportuar se Ingolitsch do

ta marrë Nuhiiun me vete në Graz si ndihmës të tij. Nuhii si lojtar ka luajtur 90 ndeshje për Altachun, duke shënuar 20 gola. Ai është emëruar ndihmëstrajner më 30 shtator të vitit 2024 dhe aktualisht është

duke përfunduar kursin për t'u pajisur me licencën "UEFA Pro". Ky kualifikim do t'i mundësonte të drejtonte klub në Bundesligën e Austrisë. Ai, po ashtu, është ndihmës i përgjigdhësit të Kosovës, Franco Foda.



FFK-ja NË BASHKËPUNIM ME UEFA-n MBAJNË PUNËTORINË E PARË MJEKËSORE NË NIVEL VENDI

PRISHTINË, 8 JANAR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me UEFA-n, ka mbajtur të enjten punëtorinë e parë mjekësore në nivel vendi, duke bashkuar në një forum të përbashkët mjekët e Superligës, Ligës së Parë, futbollit të vajzave dhe ekipeve kombëtare.

Ky aktivitet përbën një hap të domosdoshëm drejt forcimit të sistemit mjekësor brenda futbollit të Kosovës dhe vjen si vazhdimësi e projektit të FFK-së për kujdes të shtuar ndaj shëndetit të futbollistëve, pasi më parë janë dhënë donacion për klubet defribilatorët dhe është si pjesë e unifikimit të protokolleve me ato të UEFA-



s, duke i përafuar ato me standardet më të larta evropiane.

Punëtorja është drejtuar nga ekipi mjekësor i Kombëtares A të Kosovës: dr. Amir Vejseli,

Mustafë Januzaj, Argjent Hoti dhe Skifter Imeri, të cilët kanë ndarë njohuritë dhe përvojat e tyre profesionale, të fituara përmes programeve të avancuara të edukimit të UEFA-s.

Në fokus të ligjërimeve ishin temat kyçe që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e futbollistëve, përfshirë menaxhimin e atakut kardiak, trajtimin e lëndimeve cervikale, rëndësinë e fizioterapisë në fushën e futbollit, si dhe menaxhimin e lëndimeve të toraksit dhe ekstremiteteve. Pjesa teorike u plotësua me ushtrime praktike, duke ofruar qasje konkrete për veprim në

situata reale gjatë ndeshjeve dhe stërvitjeve. Mbrojtja e shëndetit të futbollistëve është themel i zhvillimit të qëndrueshëm të futbollit, ndaj ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale të stafit mjekësor mbetet një nga prioritetet strategjike të FFK-së. Përmes kësaj punëtorie, synohet standardizimi i protokolleve mjekësore, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet mjekëve të klubeve dhe ekipeve zinxhir të kombëtares, si dhe krijimi i një platforme të qëndrueshme për edukim të vazhdueshëm, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

VËRSHIMET DËMTOJNË STADIUMIN E DRENICËS, KLUBI NGA SKENDERAJ KËRKON NDIHMËN E SHTETIT

SKENDERAJ, 8 JANAR - Vërshimet e fundit kanë shkakuar dëme të mëdha në shumë qytete të Kosovës, në mesin e tyre edhe në qytetin e Skenderajt. Nga këto vërshime e ka pësuar edhe klubi i Drenicës, ku stadiumi "Bajram Aliu" u mbulua nga uji, duke shkakuar dëme në fushë e, po ashtu, edhe brenda zhyeshtores dhe pjesës tjetër të stadiumit. Skuadra e Drenicës në muajt e fundit ka investuar që stadiumi të ketë kushte sa më të mira por, fatkeqësisht, pas këtyre vërshimeve, u kthye në gjendje të pashfrytëzueshme, brenda pak orëve. Pas kësaj situatë Drenica ka apeluar për ndihmë nga Federata e Futbollit e Kosovës dhe Ministria për Kulturë, Rini e Sport në Qeverinë e Kosovës.

"Më shumë mund, përkushtim dhe shpresë, gjatë muajve të fundit kemi punuar që fusha e stadiumit të FC Drenicës t'i ketë kushtet që i meriton. Ishte një investim i bërë me zemër, për lojtarët tanë, për klubin dhe për gjithë qytetin. Fatkeqësisht, reshjet e fundit të shiut kanë shkakuar dëme të mëdha, duke e kthyer stadiumin në një gjendje të pashfrytëzueshme. Brenda pak orësh, gjithçka që u ndërtua me aq përkushtim u përball me një goditje të rëndë nga natyra. Fotot flasin vetë – si ka qenë fusha më parë, si u ndërtua pas investimeve dhe si duket sot pas kësaj fatkeqësie. Ne besojmë se këto pamje prekin secilin që e do sportin dhe të ardhmen e tij në Kosovë", është



thënë në reagimin e Drenicës, duke bërë thirrje që të mbështetet nga shteti për ta kaluar gjendjen e rënduar. "Me besim të plotë në shtetin tonë, i drejtohem i respekt Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucioneve tjera duke shpresuar në ndihmën dhe

përkrahjen e tyre në këtë moment të vështirë për klubin tonë, atyre që duan ta shohin sportin duke përparuar e jo duke u shkatërruar. Ndihma institucionale është jetike që stadiumi të rregullohet dhe që FC Drenica të ketë mundësi të vazhdojë garat në kampionat. Pa

këtë përkrahje, do të jetë jashtëzakonisht e vështirë ndoshta edhe e pamundur të vazhdojmë rrugëtimin sportiv. FC Drenica është më shumë se klub futbollit. Është pjesë e historisë sonë, e rinisë sonë dhe e krenarisë sonë. Sot kërkojmë ndihmën e të gjithë atyre që besojnë në sport, në punën e ndershme dhe në të ardhmen. Me ndihmën tuaj, shpresojmë të ngrihemi sërish dhe t'u japim lojtarëve tanë kushtet që i meritojnë. Kërkojmë ndihmë në mënyrë që të kemi mundësi ta përmirësojmë infrastrukturën përgjithmonë – për të tashmen dhe të ardhmen, për fëmijët tanë dhe për brezat e ardhshëm. Drenica është e Kosovës!", është thënë në reagimin e Drenicës.

Klubi spanjoll interesohet për Kristjan Asllanin

TORINO, 8 JANAR - Sipas gazetarit Matteo Moretto, klubi spanjoll Girona ka shfaqur interesim për të nënshkruar me mesfushorin e Interit, Kristjan Asllani, gjatë afatit kalimtar të janarit. Mesfushori shqiptar

ishte huazuar te Torino gjatë verës në një marrëveshje prej 1.5 milion eurosh, me option për transferim të përhershëm prej 12 milion eurosh. Megjithatë, klubi torinez ka vendosur ta ndërpresë

huazimin e tij pas performancave të papëlqyeshme në gjysmën e parë të sezonit. Me disa klube të Serisë A që tashmë kanë shfaqur interes për Asllanin, tani edhe ekipi nga La Liga ka hyrë në garë. Interi

synon ta shesë mesfushorin gjatë këtij afati kalimtar. Girona po kërkon përforcime për ta përmirësuar ecurinë në gjysmën e dytë të sezonit, pasi aktualisht renditet në vendin e 17 në tabelë.





- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Auto Sallon Te Arbën" SH.P.K. pronar Ferki Sokoli me seli në Vushtri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811421677 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Auto Sallon Te Arbeni" D.O.O. Ferki Sokoli Vuqitem donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811421677 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

We inform all customers that the limited liability "Auto Sallon Te Arbeni" L.L.C. with owner Ferki Sokoli with headquarters Vushtri, has come to the decision to quit its business: 811421677 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

-“Focus” SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811054387.

- Leonor Osmanaj shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Giakovë.

- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Pjeter Bogdani" Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.I. me nr. Unik: 811133719.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greicevci".

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, bane-
sa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet
me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy
muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për infor-
mata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për informund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

